



BULETIN JAVOR

22-26 KORRIK



PËRMBAJTJA

- Cyber Fortress 2024
- Zhvillohet trajnimi dy-ditor për sektorin e Turizmit dhe atë të Prodhimit mbi Sigurinë Kibernetike

Cyber Fortress 2024



AKSK, në bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizoi eventin Cyber Fortress më 23-24 korrik. Ky aktivitet dy-ditor bashkoi ekspertë të sigurisë kibernetike nga Shqipëria dhe Kosova në një simulim të incidenteve kibernetike, duke përdorur skenarë të ndryshëm dhe sfidues.

Pjesëmarrësit, të ndarë në ekipe, konkuruan për të zgjidhur skenarët e incidenteve kibernetike, duke u fokusuar në krijimin e zgjidhjeve, në vlerësimin dhe diskutimin e tyre për të arritur rezultatet më të mira.

Aktivitetet e tilla janë tejet të rëndësishme për përgatitjen dhe forcimin e kapaciteteve të ekspertëve të sigurisë kibernetike, duke qënë se mundësojnë kombinimin e zgjidhjeve teknike me buxhetin e alokuar

Ekipet e mbrojtjes nëpërmjet trajnimeve të tilla shkëmbejnë e njohuritë dhe përvojat, duke kontribuar në një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet institucioneve dhe vendeve të rajonit në përballimin e sfidave kibernetike.

Zhvillohet trajnimi dy-ditor për sektorin e Turizmit dhe atë të Prodhimit mbi Sigurinë Kibernetike

AKSK, i angazhuar maksimalisht në rritjen e kapaciteteve të stafit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si dhe institucioneve të pavarura, organizoi një trajnim dy-ditor për Sektorin e Turizmit dhe atë të Prodhimit.

Fokusi kryesor ishte njohja dhe ndërgjegjësimi i personelit të IT/ICT në fushën e sigurisë kibernetike, aftësimi për t'u përgjigjur ndaj incidenteve kibernetike, si dhe përgatitja e tyre në identifikimin e kërcënimeve nëpërmjet Cyber Drill (CD) – simulime reale të incidenteve të sigurisë kibernetike.

Ky takim u zhvillua me mbështetjen e projektit "Siguria Kibernetike e Qëndrueshme dhe e Përgjegjshme në Ballkanin Perëndimor", i implementuar nga Qendra e Gjenevës për Qeverisje të Sektorit të Sigurisë (DCAF) dhe financuar nga Mbretëria e Bashkuar.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



[@aksk.gov.al](https://www.instagram.com/aksk.gov.al)



+355 422 21 039